

ASPEKTE TË NDIKIMIT TË GJEOGRAFISË SË BESIMIT

Lexuesit: Ky shkrim bënë pjesë në kuadrin e Gjeografisë Kulturore. Si i tillë ai nuk synon e as pretendon të bejë trajtime teorike të karakterit filozofik, sociologjik apo estetik por vetëm të prezantojë informacion të argumentuar gjeografik rreth këtij problemi duke menduar se do të ndihmohet lexuesi për të kuptuar dhe zgjeruar kulturën e vetë rreth këtyre Vështjeve. Falemnderit për mirkuptimin.

Çdo besim kryesor i botës zotron një hapësirë të caktuar gjeografike. Edhe nëngrupet e sejcilit besim kanë përgjithsisht hapësirat e tyre të përhapjes. Në këtë përcaktim nuk merren parasysh interferencat dhe bashkëjetesat e komuniteteve të ndryshme brenda hapësirës së besimit kryesor.

Përhapja e besimeve kryesore në hapësira të caktuara luan një rol shumë të rëndësishëm në përcaktimin e mozaikut botëror të kulturave si dhe në shumë aspekte të tjera të jetës shoqërore e të mjedisit gjeografik. Kështu besimi luan rol në organizimin e grupit, në lidhjen e ngushtë të grupit me politikën dhe me shtetin si dhe në qëndrimin e intitucioneve të besimit përball ndryshimeve dhe zhvillimeve shoqërore. Shumë prej konflikteve në historinë botërore kanë patur një bazament fetar, dukuri që ka shprehje të shumta edhe aktualisht. Besimet influencojnë në mënyrën e të ushqyerit, të veshjes, në shkallën e tolerancës, në Vfar e si mendojnë burrat për gratë e anasjelltas, si dhe kur punojnë e festojnë, Vfar llojë sjelljesh inkurajojnë e Vfar jo, V'politikë të hartohet e V'tip shteti të ndërtohet, V'të drejta humane të aplikohen e cilat të nënvleftësohen etj. Influenca janë aq të shumta sa është shumë e vështirë të identifikohen në mënyrë preVize e të plotë. Kjo shpjegohet me faktin se besimi është moral njerëzor, është filozofi që përfshin të gjitha sferat e

Gjeografi kulturore

jetës, është pjesë e superstrukturës së shoqërisë e lidhur me të gjitha superstrukturat e tjera.

1. Besimi dhe politika.

Aktualisht, pothuaj të gjitha vendet e botës garantojnë lirinë e besimit dhe ndërkohë ruajnë e aplikojnë një formë të caktuar të shekullarizmit. Në botën e sotme ka pak shtete teokratike. SiV dihet teokracia është një formë qeverisjeje ku kleri dhe intitucionet fetare sundojnë në mënyrë direkte. Vatikani është një shtet i tillë. Maroku është një teokraci e modifikuar sepse legjitimiteti i mbretit pjesërisht rrjedh nga autoriteti i Muhametit. Në të kaluarën kanë ekzistuar shumë teokraci si p.sh. Tibeti, Kolonia e Gjirit Masachusetts në Amerikën Veriore Britanike. Utah ka qenë më parë një teokraci Marmone, bile, nga kjo trashëgimi, edhe sot asnjë politikan nuk mund të injorojë udhëheqësit kishtarë Marmonë. Izraeli ka ruajtur shumë strikt Judeizmin dhe shumë struktura të besimit judeist janë futur në ligjet kombëtarë. Kështu, në këtë kuadër në 1991 me ligj u ndalua prodhimi dhe shitja e mishit të dërrit, u ndaluan aktivitetet të shtunën e cila është ditë pushimi për festime sipas besimit ebre.

Kristianizmi që në fillimet e tij ka bërë dallimin midis rendit politik dhe besimit. Ky dallim i dha mundësi Europës që të ndërtojë kryesisht shtete shekullare, dijet shekullare dhe kulturën shekullare. Megjithatë, disa vende janë sot qartësisht kristiane ose të paktën mbështesin me fonde publike një variacion sektesh. Të tilla janë Anglia, Gjermania, Irlanda, Suedia, Norvegjia, Danimarka, Islanda, Finlanda, Argjentina, Peruja. Në të njëjtën kohë kemi edhe vende zyrtarisht islamike si Mauritania, Libia, Arabia Saudite, Jemeni, Omani, Katari, Bahrein, Iraku, Irani, Afganistani, Pakistani, Bangladeshi, Malajzia, e ndonjë tjetër. Shtetet zyrtarisht islamike kanë futur në ligj mësimin islam në shkollë që quhet Sharia si dhe kanë krijuar gjykatën Sharia e cila ka detyrë të përcaktojë nëse një ligj i caktuar shekullar është në përputhje me mësimet islamike apo jo. Në qoftë se gjykata Sharia vendos të kundërtën atëherë ligji anulohet menjëherë. Islamizmi i shikon principet funksionale të qeverisë në atë mënyrë që të drejtojnë individin mysliman të ndjekë një jetë të mirë myslimani. Kjo është masa e legjitimitetit

Gjeografi kulturore

të qeverisë. Në këtë drejtim forcat fundamentaliste luajnë një rol të konsiderueshëm dhe influenca politike e tyre ka ardhur duke u forcuar. Analistët konstatojnë se këto forca fundamentaliste e shikojnë demokracinë më shumë si një mjet për të krijuar një shtet islamik se sa si një sistem vlerash shoqërore civile. Vet Ayatollah Khomeini ka thënë : “ Ne nuk themi që qeveria duhet të jetë e përbërë nga klerikë por që qeveria duhet të jetë e drejtuar dhe e organizuar sipas ligjeve hyjnore dhe kjo është e mundur me mbikqyrje të klerit”

Në të gjitha vendet besimi mbizotruar mund të diktoj etikën nacionale ose morale. Meqënëse përfaqson një moral e filozofi që e ka shoqëruar shoqërinë njerëzore që nga fillimet e saj, atëherë, një kompleks normash, sjelljesh e veprimtarishë si dhe një mënyrë të menduarit janë bërë të natyrshme te njëri. Prandaj dhe aktualisht besimi vepron thellësisht në atë Vka populli pranon të bëhet në mënyrë të natyrshme ose të bëhet një normë njerëzore e dëshirueshme apo edhe një ligj i shtetit. Në këtë kuptim, besimi kurrë nuk mund të jetë i nënvleftësuar si në aspektin politik e institucional as edhe kulturor etj.

Lidhjet midis qeverisë dhe organizmave të besimit përbëjnë një Vëshetje të madhe politike në shumicën e vendeve. Liderit e besimit mund të ndihmojnë ligjvënësit, mund të jenë në përkrahje të qeverisë por mund edhe të pozicionohen nga ana e opozitës duke bërë për vehte në këtë anë kontigjente të konsiderueshme njerëzish. Kështu ato bëhen një forcë mbështetëse e lëvizjeve për ndryshime. Një kishë nacionale mund të mbështesë një nacionalizëm të shprehur dukshëm në jetën politike e shoqërore të vendit, siç është rasti në Ukrainë dhe Irlandë. Kisha katolike polake qendroi kundër partise komuniste dhe shtetit komunist si një alternativë besnikërie e identitetit të kombit për gjithë periudhën 1945 - 89, duke patur edhe një mbështetje të madhe në popull. Një shembull është edhe qendresa e kishës në Shqipëri, sidomos asaj katolike, por e shprehur kryesisht me qendresën e klerikëve.

Në shumë vende popullsia e një besimi të caktuar mund të krijojë edhe parti politike, siç është Partia Demokristiane, që ekziston në shumë vende të Europës. Po kështu edhe besimi islamik bashkon besimtarët në parti politike islame si p.sh. në Turqi

Gjeografi kulturore

(Erbakami), në Pakistan e në vende të tjera. Në mjaftë raste, forci i këtyre partive islamike, ka cënuar karakterin shekullar të shtetit si në Turqi, Indi etj. Ka raste kur bashkqytetarët e një shteti mund të armiqsohen me qeverinë e tyre kur shohin se bashkbesimtarët e vendit fqinjë gëzojnë më shume liri besimi se sa ata. Kështu p.sh. fuqia islamike e Iranit mbështeti aspiratat islame të popullsisë myslimane të vendeve të Azisë Qendrore nën sundimin e Bashkimit Sovjetik Komunist.

Tensione politike të vërteta krijohen kur në një vend ekzistojnë besime të ndryshme në kuptimin esencial. Në jetën politike të këtyre vendeve, kur diskutohet për të vendosur ligjet dhe krijimin e natyrës së shtetit apo edhe për të vendosur norma të ndryshme shoqërore, mund të ndodh që ose të arrihet kompromisi por edhe mund të vuajnë për shumë kohë pasojat e konflikteve që mund të krijohen. P. sh. Në Sudan, përpjekja për të imponuar Sharia-n, shkaktoi konflikt midis myslimanëve që dominonin në veri dhe kristianëve e animistëve që dominonin në jug. Në Filipine tensionet midis myslimanëve dhe kristianëve, sidomos në ishujt, shkaktuan revolta kundër qeverisë qendrore. Në Nigeri, në kohën e diskutimeve për legjislacionin, midis myslimanëve dhe kristianëve pati shume tensione, shoqëruara me masakra të shumta. Edhe Libani vuajti shumë nga tensionet religioze pasi fitoi pavarësinë prej Francës pas luftës së II-të botërore. Kompromisi u arrit vetëm në vitin 1991. Shumë të ashpra e me pasoja të rënda kanë qenë konfliktet me bazë besimi në nënkontinentin Indian. Anglia synonte që në prag të pavarësisë së Indisë ta krijonte këtë si një shtet shekullar por shumë musliman kërkuan që të ndahen e të krijojnë një shtet të pavarur mysliman. Kështu, kur u shpall pavarësia më 1947, popullsia myslimane me miliona u shpërgul nga India për në Pakistan dhe themeloi shtetin e Pakistanit Perëndimor e Lindor (më pas ky i fundit krijoi shtetin e pavarur të Bangladeshit). Po kështu, miliona Hindu u larguan nga Pakistani e u vendosën në Indi. Këto lëvizje të mëdha të popullsisë u shoqëruan me tensione e konflikte të mëdha dhe me dhjetra mijra vdiqën për shkak të akteve të shumta të violencës. Në 1971 në Pakistan shpërthyen përsëri revolta midis sektit Suni dhe sektit Shit sepse besnikëria fisnore e lidhur me sekte të ndryshme nuk mundësoi një marrveshje të

Gjeografi kulturore

qendrueshme. Në vende të tjera, tensionet që në dukje kanë bazë fetare, në fakt nuk kanë vetëm këtë shkak, Në to ka interferenca të politikave ndërkombëtare e sidomos të të mëdhenjëve, mund të përmendim Irlandën. Izraelin etj.

2. Besimi dhe ekonomia.

Studiuesit kanë vënë re se ka një lidhje të ngushtë midis besimit dhe ekonomisë, sidomos në disa aspekte. Besimi mund të ndikojë në mënyrën se si njerëzit fitojnë paratë apo krijojnë pasuri (kapitale), gjë që ndikon në tërë zhvillimin e shoqërisë. Në përgjithsi të gjitha besimet ndalojnë ose dënojnë mbingarkesën e interesit vetjak sepse, mes tjerave, kjo gjë Von në fitimin e shumë avantazheve ndaj të tjerëve, krijon një pabarazi të dukshme, gjë që vlerësohet si pandershmeri. Kjo nuk mohon faktin që feja e konsideron të shenjtë pronën private. Mësimet kristiane, duke e shtjelluar këtë problem, kanë evoluar në konceptimin e huadhënies. Për kristianizmin është e dënueshme dhënia e parave hua, kur tjetri i merrë ato për të blerë sende për të jetuar, kjo do të ishte mëkat. Por, nga ana tjetër, e justifikon huadhënien kur tjetri i merrë ato për të bërë investime legale në bizneset të ndryshme sepse kjo ka rrjedhoja pozitive. Nga ana e vet, mësimet islame, nuk e bëjnë një diferencim të tillë, por dënojnë Vdo lloj huadhënie dhe Vdo lloj interesi ekonomik vetjak. Gjyqi Sharia i Pakistanit në 1992 vendosi me ligj se interesi është jo islamik dhe ilegal. Mirpo ky ligj rrezikoi Pakistanin që të hyjë në sistemin monetar ndërkombëtar dhe në tregëtinë ndërkombëtare.

Sociologu gjerman Max Weber në veprën e vet "The protestant Ethic and the Spirit of Capitalism" (1904), shkruan se protestantizmi inkurajon individualizmin. Prandaj me përhapjen sa më shumë të këtij besimi në Europën Perëndimore e në Amerikë, u rritën më shumë të ardhurat si rezultat i vlerësimit dhe zhvillimit aktiv të aftësive individuale në tregun e lirë, aq sa kjo u bë një virtyt i njohur në këto vende. Në fakt, sot vihet re që kjo etikë karakterizon aderuesit e pothuaj të Vdo besimi dhe referohet si "etika e punës" Analistë të shumtë dhe kompani të mëdha të medias së shkruar si Wall Street Journal, Business Week, Forbes, etj, vërejnë dhe sanksionojnë lidhjen midis protestantizmit dhe sukseseve në ekonomi.

Gjeografi kulturore

Kisha katolike ka mbrojtur gjithmonë dhe mbron konceptin se kapitalizmi është më superior se socializmi. Papa Gjon Pali II-të, në enciklikën e Tij "One Hundred Years" (1991), thekson se "Në nivelin e kombeve individuale dhe të marrdhënieve ndërkombëtare, tregu i lirë është instrumenti më efektiv i përdorimit të resurseve dhe të përgjigjes në mënyrë më efektive të nevojave" Por në të njejtën kohë, Papa insiston që ky kapitalizëm duhet të jetë më i zbutur në lidhje me drejtësinë sociale dhe dinjtetin human.

Tradita e filozofisë Konfuciste në Azinë Lindore, jep një shembull tjetër të influencës së besimit në ekonomi. Kjo traditë vlerëson në radhë të parë rolin e lidërshiptit, aftësinë dhe intiligjencën e drejtuesëve të pajisur edhe me moralin dhe obligimin e nevojshëm për të udhëhequr popullin. Kjo gjë, sipas tyre, rrit kapacitetin e punës në burokracinë qeveritare, Kjo filozofi vazhdimisht aplikohet në krijimin e stafeve të larta udhëheqëse sidomos në bordet ku studiohen dhe merren vendimet e zhvillimit ekonomik, duke tërhequr vazhdimisht të rinj të talentuar në këto borde. Kjo metodë u jep shumë qeverive aziatike më shumë legjitimitet dhe kompetencë në punët e biznesit, aq sa konkurojnë edhe me Sh.B.A. që dallohet dhe është e para në përpjekjet për të bërë ekonomi të suksesshme. Për shkak të traditës fetare e filozofike, popujt Azisë Lindore, sidomos të Japonisë, Koresë së Jugut, Hong Kongut, Singaporit, Kinës (veanarisht ngulimet kinezë kudo në botë), dallohen për bindje, normë të lartë kursimi, zellshmëri në punë. Kjo gjë, kombinuar me arsyetimin e mësipërm, përbën një bazament shumë të mirë për punë biznesi të suksesshme. Ka ndodhur jo rrallë që misionarët kristian protestant, që kanë propaganduar idetë e tyre mbi individualizmin, janë dëbuar të diskretituar nga këto vende, të akuzuar edhe me akuzën se kanë dashur të shkatërrojnë konfucizmin e këtyre vendeve.

Është i njohur fakti se besime të ndryshme trashëgojnë dhe manifestojnë zakone të ndryshme në lidhje me shëndëtarinë ndaj bimëve dhe kafshëve të ndryshme, gjë që ka ndikuar shumë në disa aspekte të zhvillimit të ekonomisë bujqësore e blegtorale, në dietën e të ushqyerit dhe mënyrën e jetesës. Kështu, sot në botë janë 270 milion budistë vegjetarianë. Ka të dhëna se rreth

Gjeografi kulturore

10% e amerikanëve janë vegjetarianë, Ekzistojnë 620 milion Hindu që nuk hanë gjedhin, sepse e konsiderojnë atë kafshë të shenjtë. Lopët atje mbushin rrugët e sheshet dhe askush nuk mund t'i ngacmojë. Ato përdoren si objekte frymëzimi për të bërë art(pikturë,skulpturë etj), përdoren për të marrë qumësht kurse ekstremetet për plehërim dhe lëndë djegëse. 17 milion ebrej dhe qindra milion muslimanë, nuk hanë mishin e derrit sepse e quajnë atë kafshë të papastërt, si dhe nuk përdorin alkolin. Ka grupe më të vogla që kanë rregulla më strikte. Kështu komunitetet giainiste indiane, që numurojnë 3 milion, nuk mund të vrasin as edhe një lloj qenie të gjallë. Në disa tribu barinjësh të Afrikës Lindore e Jugore, vërehen ekstreme të tjera. P.Sh. midis popullsisë Pakot të Kenias, numuri posedues i lopëve nga një mashkull është i lidhur drejtpërsëdrejti me prestigjin e tij si burrë në shoqëri. Lopët shërbejnë si objekte shkëmbimi kur është puna sidomos për të kërkuar grua për martesë. Animistët,(populli e përhapur në Afrikën Jugore, në Indi ,Birmani , në pjesën jugore të Gadishullit Arabik), nuk përdorin dhjainin e pulës dhe vezët. Kështu këto vende zhvillojnë një ekonomi të përshtatshme bujqësore e blegtorale në varësi me këto rregulla të lidhura me besimin.Konstatohet se vendet që nuk përdorin mishin janë importueset më të mëdha të perimeve e zarzavateve, siV është sidomos India.Shembull shumë interesant i ndikimit të besimit në ruajtjen e traditave të vjetra në aspekte të ndryshme të jetës është popullsia menönite që numuron sot në botë rreth 370000 njerës, gjysma e së cilës jeton në Amerikën veriore. Kjo popullsi ndjek kodin fetar **Amish**. Ky besim u shfaq në formën e një sekti në fillim të viteve 1600 në Zvicër si antikonformist me protestantizmin. Kjo popullsi në grupe të caktuara është e instaluar në rajonet agrare midis një hapsire shumë të zhvilluar dhe me tendenca të shpejta ndryshimi. Këto komunitete nuk përdorin pajisjet modernen, nuk përdorin dritën elektrike, telefonin, makina,etj. Në vend të tyre përdorin karroca , kandilë, vishen si në mesjetë etj. Kështu me jetën e tyre ato të kujtojnë Europën e vitit 1600, duke kontrastuar me Amerikën në vigjilje të vitit 2000.

Në shumë vende, një besim i caktuar mund të bëhet ose ë jetë posedues i madh tokash e financash, burim për të cilat janë

Gjeografi kulturore

e drejta e pronësisë së trashëguar, dhuratat nga besimtarët dhe nga donatorë të ndryshëm privatë, por edhe shtetrorë. Kjo pronësi, krijohet për qellime të caktuara dhe në përgjithësi, organizmat fetare, nuk bëjnë shumfishimin e pasurisë nëpërmjet përdorimit të saj për fitim. P.Sh, kisha nuk taksohet sepse nuk nxjerr fitim nga prona që posedon, por e përdor atë për ekzistencën e vetë dhe për ndihma humanitare.

3. Besimi dhe të drejtat e gruas.

Besimet ndryshojnë mjaftë midis tyre përsa i përket problemit të qendrimit ndaj gruas, bile edhe i njejtë besim ka ndryshime të caktuara nga njeri vend në tjetrin. Këto ndryshime reflektojnë ndryshimet në kulturë dhe në trashëgiminë në përgjithësi që karakterizon Vdo vend e popull. Për këtë arsye, ka edhe raste që është e vështirë të preVizohet se sa ndryshimet e qendrimeve ndaj gruas lidhen me besimin e atij vendi.

Kisha katolike duke qenë e centralizuar, zbaton rregulla e parime më të fksuara ndaj gruas që lidhen si me aktin e martesës dhe të jetës bashkëshortore, kur kurora celebrkohet në kishë, nuk pranon abortin dhe planifikimin familjar, është absolutisht kundër klonimit që vjen në kundërshtim me qënien e njeriut si krijesë e zotit, e vlerëson gruan si të barabart me burrin sepse të tillë janë para zotit etj. Besimi në përgjithësi konsiderohet një faktor kryesor i frenimit të përhapjes së praktikave të kontrollit të lindjeve. Në Dhiatën e Vjetër, ka përshkrime që trajtojnë problemin e kontrollimit të popullimit po ashtu edhe në afresket e vjetra Egjiptiane, duke filluar që 5000 vjet a.C. Ka shumë dëshmi që grupe të caktuara humane gjatë historisë kanë qënë në gjendje të kontrollojnë dimensionin familjar. Por vlerat morale që i atribuohen fetusit human në doktrinën kristiane katolike, përbëjnë një barrierë me rëndësi fundamentale për ndalimin e abortit dhe të përdorimit të mjeteve dhe metodave kontrceptive. Ky parim me karakter pengese, bëhet e mundur të bëhet një problem i politikës nacionale në vendet ku ekziston një lidhje e fortë midis kishës katolike e shtetit. P.sh. në Irlandë janë të ndaluara absolutisht mjetet e metodat kontrceptive. Në Sh.B.A. shtete të ndryshme kanë qendime të ndryshme ndaj abortit. Nga studimet që i është bërë këtij problemi, rezulton se në shoqëritë e civilizuar

Gjeografi kulturore

nuk del aq i domosdoshëm planifikimi familjar. Argument për këtë është fakti së vendet që nuk realizojnë planifikimin familjar dhe nuk përdorin mjetet contraceptive, nuk karakterizohen nga natalitet i lartë, lindëshmeria është e njëjtë si në popullsinë katolike të Europës ashtu edhe në atë jo katolike.

Kisha Anglikane është më pak e centralizuar, gjë që shprehet në faktin se megjithë rregullat e parimet kristiane që mbron si kishë kristiane, ajo u jep mundësi komuniteteve të ndryshme lokale Anglikane të kenë qendrimet e tyre, që rrjedhin nga veVoritë tradicionale kulturore lokale. Në Amerikë të drejtat e gruas janë të mbrojtura në shumë aspekte, ka një hapësirë lirie më të madhe, nga e cila, kisha anglikane atje, ka lejuar dhe shuguruar edhe një peshkope grua, gjë që nuk është pranuar nga kisha anglikane në vende të tjera.

Edhe besimi islam njih dhe mbron të drejtat të gruas por midis doktrinës islame dhe asaj kristiane ka edhe ndryshime për sa i përket kësaj Vështjeje. Në Kuran "lista" e të drejtave të gruas është e gjerë dhe njëkohësisht, në një farë mase, e lirë nga vendi në vend e nga koha në kohë. Në fakt, në jetën praktike vërehen disa kufizime që nuk i gjejmë në praktikën kristiane. Në këtë drejtim mund të përmendim të drejtën e burrit për të patur katër gra, gjë që i mohohet gruas, detyrimi i gruas islame për të dalë e mbuluar me velë në publik (sidomos detyrim është në disa vende si Arabia Sudite, Irani, Pakistani, Afganistani e ndonjë tjetër), dëshmia e një gruaje në gjyq vlen sa gjysma e dëshmisë së një burri etj. Në vendet ku fundamentalizmi është më i fortë, gruaja nuk lejohet të punojë jashtë shtëpisë. Në disa vende me karakter shekullar, janë miratuar ligje qe lejojnë planifikimin familjar, të drejtën e gruas për të kërkuar divorcim, heqja e të drejtës për të mbajtur 4 gra (poligamia). Fundamentalistët kërkojnë që këto ligje të anulohen dhe ushtrojnë presion të vazhdueshëm. Kështu në revolucionin Iranian në 1979 u hoqën shumë ligje progresive që ishin miratuar në kohën e Shahut. Në Egjipt në 1985 u hoq ligji qe i jepte të drejtë gruas të divorcojë burrin kur ai don një grua tjetër, ligj i aprovuar ky në 1975. Regjimi militar i Sudanit më 1989, refuzoi të lejojë gruan të dalë jashtë shtetit pa qënë e shoqëruar nga baba, vëllai apo burri i vet. Në Algjeri, në vitin 1984, kodi familjar i dha burrit të drejtën të

Gjeografi kulturore

divorcojë gruan e tij për Vfarolloj arsyeje të tijën. Interesant është fakti së mësimet fetare islame, të bëra sipas Kuranit, ngrejnë rolin e gruas në politikë. Mbi këtë bazë, ka shumë vende islamike që, si në të kaluarën ashtu edhe aktualisht, kanë gra që janë në postet më të larta të shtetit deri kryeminstre si në Pakistan etj. Pra vihet re një vlerësim më i madh i gruas në librin e shënjtë islamik, Kurani dhe më pak të drejta të realizuara në praktikën jetësore të këtyre vendeve.

4. Besimi dhe mjedisi

Gjeografia e besimeve të ndryshme luan një rol të rëndësishëm në Gjeografinë e Mjedisit. Në bazë të kalendarve fetare, njerëzit kryejnë një numur të konsiderueshëm veprimtarishë njerëzore, festojnë në ditët e festave, shkojnë në vendet e tyre të shenjta dhe në institucionet e besimit. Në këtë mënyrë krijohen mjedise sociale me grumbulime të mëdha njerëzisht të cilët kryenë aktivitetet e tyre fetare, zhvillohen lidhje dhe bashkpunime të reja. Në këto vende zhvillohen edhe veprimtari ekonomike tregtare ambulante duke ndërtuar panairë të bukura dhe tërheqëse.

Besimet e ndryshme ndërtojnë institucionet e tyre dhe infrastrukturën përkatëse të tyre si kisha, manastire, xhami, teqe, shesh, parqe, rrugë, shkolla, qendra kulturore, qendra sportive etj. Të gjitha këto zenë territore jo të vogla në hapsirë duke u bërë kështu burim i mjediseve të reja dhe specifike në kuadrin e mjedisit të përgjithshëm social. Shpesh ngritja e infrastrukturës së besimit bëhet fillesa e ndërtimit në të ardhmen të një qendre të madhe qytetare duke i dhënë edhe emrin qyteteve si Islamabad, Meka, San Paolo, sheshi San Antonio, San Fran Visko etj. Jo vetëm në vende të përqendruara, por objektet e shumta të besimeve të ndryshme, gjenden kudo të përhapura në hapsirë. Në varësi nga besimi dominues ato mund të jenë më shumë kristiane, islame, budiste etj dhe kështu krijojnë një imazh të caktuar mjedisor me një përmbajtje të identifikuar fetare.

Besimet trajtojnë me kujdes territorin duke e shfrytëzuar në mënyrë të drejtë dhe ekologjike, shqetësohen dhe prononcohen vazhdimisht për degradimet e natyrës dhe rekomandojnë apo kontribuojnë konkretisht për mbrojtjen e përmirsimin e situatës

Gjeografi kulturore

ekologjike të mjedisit gjeografik dhe për rritjen e vlerave prodhuese të tij.

Literatura e konsultuar.

1. Grup autorësh. Il Caso Europa. Evangelizzazione e processi di omologazione culturale. Milano 1991.
2. Edward F. Bergman, Tom L. McKnight: Introduction to Geography, New Yersy, 1993.
3. Peter Hegget. Geografia - Una sintesi Moderna. Bologna, 1997
4. Aleanca Biblica Universale: La Bibbia. Aleanca Biblica Universale, Via dell' Umilta', 33- 00187, Roma, 1986.
5. KUR'AN-i Përkthim me komente në gjuhën shqipe, P- Box 3561, Medinë.

As.Prof.Dr. Trifon Ziu